



RAPORT VJETOR **2008**

Forumi për Iniciativa Qytetare

Raporti Vjetor 2008



Design by: XHAD studio

Përmbajtja

FORUMI PËR INICIATIVA QYTETARE	4
LETËR NGA DREJTORI EKZEKUTIV	4
PROGRAMET E FIQ	5
I. SUNDIMI I LIGJIT	5
<i>Mbikëqyrja civile e sektorit të sigurisë.....</i>	<i>5</i>
<i>Seri debatesh lidhur me misionin e EULEX-it.....</i>	<i>6</i>
<i>Konferencë "Armët e vogla dhe siguria njerëzore në Kosovë"</i>	<i>7</i>
<i>Siguria në shkolla.....</i>	<i>7</i>
<i>Përgjegjshmëria e institucioneve demokratike ndaj shoqërisë civile.....</i>	<i>8</i>
II. QYTETARIA AKTIVE.....	8
<i>Aksioni Qytetar FOL'08.....</i>	<i>8</i>
III. DHËNIA E GRANTEVE - MBËSHTETJA E INICIATIVAVE QYTETARE.....	9
<i>Mbështetja përfshatin Raushiq, Pejë.....</i>	<i>9</i>
<i>Fshati Lubinje e Epërme, Prizren</i>	<i>10</i>
AKTIVITETE TJERA	10
REAGIMET	10
VIZITAT ME RËNDËSI	10
FUQIA E ARTIT - SHFAQJA TEATRALE "E VËRTETA NË PËRKTHIM"	11
PARTNERËT DHE DONATORËT	12
PASQYRA FINANCIARE E AUDITIMIT	12
STAFI.....	13

Forumi për Iniciativa Qytetare

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare e përqendruar në sundimin e ligjit që punon për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim-marrëse, për një rajon ballkanik të zhvilluar ku mbretëron paqja dhe drejtësia. FIQ-i është krijuar në vitin 2000 në mënyrë që të adresoj nevojat urgjente në Kosovën e pasluftës. Prej atëherë, FIQ është zhvilluar në organizatë të përqendruar në sundimin e ligjit, transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë si dhe në forcimin e kapacitetit të shoqërisë civile. FIQ e bënë këtë përmes studimeve dhe analizave, diskutimeve, trajnimit dhe dhënies së granteve.

FIQ me shumë kënaqësi punon me të gjithë partnerët, komunitete dhe qytetarët aktiv të Kosovës dhe atë në mënyrë të përshtatshme, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj konfliktit. FIQ angazhohet që të krijojë marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi me institucionet tona dhe ato ndërkombëtare, për të rritur kështu ndikimin e punës e vet për të mirën e përgjithshme.

Letër nga drejtori ekzekutiv



Të dashur lexues,

Këtë vit, Kosova hyri në fazën e ndërtimit dhe konsolidimit të vet, ku kontributi i secilit individ do të ketë peshën më të madhe se kurdoherë. Filloi koha që nuk guxon të humbet më - lidershipi Kosovar duhet të punojë në krijimin e vizionit për të ardhmen e këtij vendi të sapo pavarësuar.

Tani institucionet tona kanë mundësinë të dëshmojnë se mund të zbatojnë praktikatat më të mira të demokracisë për të qeverisur vendin.

Kosova nuk kishte shumë kohë për festë, meqë konfigurimi institucional, edhe përkundër pavarësisë së vendit mbeti kompleks dhe i ndërlikuar. Për më tepër, ai mbeti i paqartë për popullin, e në shumë raste edhe për vet institucionet. Prania e misionit të EULEX/UNMIK nuk ishte lehtë për t'u vënë në zbatim, e sidomos nuk ishte lehtë të shiheshin rezultatet e tij.

Menjëherë pas pavarësisë, u vu re nevoja e qartësimi të përgjegjësisë të institucioneve tona dhe atyre ndërkombëtare, meqë vendim-marrja në Kosovë filloi të vonohej dhe llogaridhënia kundrejt qytetarit u vështirësua shumë. Kuvendi i Kosovës punoi me intensitetin më të plotë të parë ndonjëherë, por dëmi ishte se kuvendarët tanë votuan ligje për të cilat kurrë më parë nuk kishin debatuar në kuvend. Në fakt, ata nuk po miratonin ligje, ashtu siç bënë bota parlamentare, por pako ligjesh me lloj-lloj ligje që derivonin nga plani i Presidentit Ahtisaari.

Viti i pavarësisë, edhe për FIQ, ashtu si për më shumë se dy milion qytetarë të vendit ishte vit i suksesit dhe prosperitetit të gjithanshëm. FIQ arriti të zhvillojë në masë të madhe programet e veta, të punojë në profilizimin e vet në kuadër të botës së vogël të shoqërisë civile në Kosovë, duke e forcuar kështu krahun e vet të grant dhënies. FIQ rriti ndikimin e vet në mbikëqyrjen e punë se institucioneve të pavarura. Për më shumë, arriti të krijojë një rrjet të shkëlqyeshëm bashkëpunimi me organizata nga mbarë Kosova, si dhe arriti të mbështesë shumë projekte me përfitim direkt në qytetarin e Kosovës.

FIQ vazhdoi të punojë me donatorët të cilët krijojnë hapësirë për origjinalitet, neutralitet dhe me të cilët agjenda kryesore është prosperiteti i njerëzve nëpër botë. Faleminderit të gjithë ju që punuat me ne! Faleminderit donator të nderuar që mbështetët FIQ në mënyrë që FIQ të mbështesë të tjerët!

PROGRAMET E FIQ

FIQ nisë dhe zhvillon projekte vetëm ose së bashku me partnerët e përzgjedhur. Kryesisht projektet përfshihen në kuadër të tri programeve:

- I. Sundimi i Ligjit,
- II. Qytetaria Aktive dhe
- III. Dhënia e Granteve.

Secili program parimisht përpiket t'u përgjigjet ca pyetjeve me rëndësi: Si mund programet tona të kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie aktive duke mos lënë askënd pas? Cila do të jetë mënyra më e mirë për të arritur këtë? Cili është roli dhe përgjegjësia e secilit prej nesh? Si mund të krijojmë komunitet të qëndrueshme në Kosovë? Programet e FIQ-it mund të shikohen si tri strategji për t'u dhënë mundësi ideve dhe njerëzve për të ndërtuar një shoqëri aktive dhe mbi të gjitha për të përkrahur dhe kontribuar në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit.

I. Sundimi i ligjit

Në kuadër të këtij programi i cili synon të rrisë rolin e shoqërisë civile në mbikëqyrjen e institucioneve të sundimit të ligjit, për t'i bërë ato më efektive dhe më llogaridhënëse kundrejt qytetarëve, ju më poshtë mund të lexoni aktivitetet ndër më të rëndësishmet gjatë këtij viti:

Mbikëqyrja civile e sektorit të sigurisë



Historikisht, institucionet e sigurisë në Kosovë deri në vitin 1999, janë parë kërcënim i jetës private, sidomos policia, shërbimi inteligjent dhe ushtria, përfshirë sistemin gjyqësor. Këto institucione nga qytetarët nuk janë parë si garantues dhe promovues të të drejtave dhe lirive të tyre, por si mjet i shtetit për kontroll të jetës individuale dhe familjare, madje si ushtrues të dhunës e represionit të vazhdueshëm ndaj qytetarëve.

Projekt ky i cili u mbështet nga Rockefeller Brothers Fund (Fondacioni i Vëllezërve Rockefeller) synonte të krijonte një platformë komunikimi dhe bashkëpunimi të nevojshëm mes institucioneve të Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile, për të rritur kështu llogaridhënien e institucioneve të Kosovës kundrejt qytetarëve. Roli mbikëqyrës i organizatave të shoqërisë civile është themelor për të siguruar që:

- Draftimi dhe aprovimi i politikave të bëhet në mënyrë të përshtatshme duke marrë parasysh kontekstin e zhvillimit politik, ekonomik dhe shoqëror të vendit,
- Në procesin e draftimit të politikave si dhe vendimeve të ndryshme të ketë pjesëmarrje dhe pronësi të qytetarëve,

Forumi për Iniciativa Qytetare

Raporti Vjetor 2008

- Që implementimi i po këtyre politikave mbikëqyret nga akterë të jashtëm të shoqërisë civile.

Përmes këtij projekti, FIQ udhëhoqi punën e rrjetit të përbërë nga tetë organizata nga komunat më të mëdha të vendit, të cilat përmes hulumtimit sistematik qenë angazhuar në vëzhgimin e punës së institucioneve të sigurisë, identifikimin e mekanizmave për jo/transparencë, promovimi publik i punës së tyre, gatishmëria e institucioneve për të ndërtuar bashkëpunim me shoqërinë civile, si dhe mekanizmat llogaridhënës të këtyre institucioneve ndaj qytetarëve të Kosovës.

Të gjetura kryesore të hulumtimit i cili ishte themelore e projektit do të prezantohen në vitin 2009.

Seri debatesh lidhur me misionin e EULEX-it

FIQ dhe Saferworld, dy organizata partnere që nga viti 2005, organizuan në nëntor dhe dhjetor të vitit 2008 një seri debatesh në qytete të ndryshme të Kosovës lidhur me misionin e EULEX-it, ndikimin dhe fuqinë e



këtij misioni në sundimin e ligjit dhe forcimin e zbatimit të ligjit në Kosovë. Ky mision vinte në Kosovë si pjesë e asaj që ishte konceptuar nga bashkësia ndërkombëtare për të mbikëqyrë pavarësinë e Kosovës. Një mision i madh i BE-së, që vinte pas UNMIK-ut si misioni më i madh i OKB-së, por që linte një konfigurim kompleks dhe të diskutueshëm ndërkombëtar në vend. Qëllimi kryesor i nismës dhe organizimit të këtyre debateve ishte që t'u mundësohet qytetarëve, shoqërisë civile, dhe gjithë opinionit publik të vendit që të mësojnë rolin, veprimet dhe mandatin e EULEX-it në Kosovë. Poashtu, qëllim tjetër më rëndësi ishte identifikimi i mekanizmave llogaridhënës të këtij misioni në Kosovë.

Në debatet e organizuara, pjesëmarrësit kanë pyetur dhe komentuar për punën e prokurorëve, gjykatësve dhe policëve të EULEX-it në lëndët rreth krimeve të rënda, krimit të organizuar, korrupsionit, të drejtave të njeriut, uzurpimit të pronave, pastaj formën sesi do të zbatohet monitorimi i punës së institucioneve vendore, qasjen dhe kufizimet e ndërhyrjes në punën e institucioneve vendore, fatin e njerëzve të zhdukur, për shume çështje që lidheshin me uzurpimin e pronave, funksionimin e doganave në veri të Kosovës dhe shumë brenga të tjera.

Në të gjitha debatet, në përbërjen e panelit diskutues merrnin pjesë zyrtarë të lartë të tri komponentëve të EULEX-it, drejtësisë, policisë dhe doganave, dhe përfaqësues të pushtetit komunal, gjyqësisë e prokurorisë dhe policisë së Kosovës.

Këto debate janë mbështetur financiarisht nga Qeveria gjermane dhe britanike, si pjesë e programit të përbashkët të punës së FIQ dhe Saferworld në Kosovë, të quajtur "Vend i Sigurtë".

Konferencë “Armët e vogla dhe siguria njerëzore në Kosovë”



Më 20 nëntor në Prishtinë, FIQ dhe Saferworld kanë organizuar konferencën “Armët e vogla dhe siguria njerëzore në Kosovë”, ku morën pjesë afro 80 pjesëmarrës nga shoqëria civile, institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare. Konferenca kishte për qëllim të promovojë debatin mbi çështjet që ndërlidhen me armët dhe sigurinë e qytetarëve dhe të avancojë bashkëpunimin ndërmjet të gjithë bartësve të përfshirë në përmirësimin e sigurisë së qytetarëve të Kosovës.

Ndër referuesit në këtë konferencë ishin Dukagjin

Gorani, këshilltar për siguri i kryeministrit të vendit, Shqipe Krasniqi nga Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, nënkolonel Naim Rexha, drejtor i Departamentit për Çështje të Komunitetit, dr.Basri Lenjani, drejtor i Qendrës Emergjente në QKUK, Musli Marevci nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj, Luljeta Vuniqi nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Rexhep Shkodra nga Federata e Gjuetarëve, Rrahim Sylejmani, përfaqësues i fshatit Gërmovë të Vitisë, Alain Lapon nga UNDP-KOSACC.

Në këtë konferencë, FIQ dhe Saferworld, duke vazhduar për të tretin vit serinë e hulumtimeve mbi perceptimet rreth armëve të vogla dhe të lehta, dhe sigurinë njerëzore, publikoi publikimin më të fundit hulumtues “Përmes vënies në objektiv – hulumtim mbi ndryshimin e qëndrimeve ndaj armëve të vogla në Kosovë”. Ky studim trajton ndryshimet në perceptime sa i përket posedimit civil dhe përhapjes së armëve, dhe sugjeron çështjet kyçe që duhet të merren parasysh në hartimin e një kornize për grumbullimin dhe kontrollin e armëve.

Siguria në shkolla

Duke konsideruar shkollimin si çështje prioritare në avancimin dhe përmirësimin e jetës në Kosovë, FIQ mbështeti me të gjitha mundësitë komunitetin shkollor të Gjilanit në përpjekjet e tyre për të pas një mjedis më të sigurt shkollor dhe një cilësi më të mirë shkollimi. Atraktiviteti i Këshillit të Nxënësve të këtij qyteti në idetë e tyre origjinale për të dërguar mesazhe paqe dhe edukimi, kanë shtyrë FIQ të mbështesë kampanjën e tyre të grafiteve. Kjo kampanjë është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me drejtorët e shkollave, drejtorisë komunalë të Arsimit si dhe është mbështetur edhe nga Kryetari i Komunës.

FIQ vazhdoi përkushtimin në aktivitet lidhur me sigurinë në shkolla dhe mbështetur nga fondacioni amerikan Balkan Trust for Democracy (BTD), realizoj projektin për përmirësim të sigurisë në shkolla edhe në kryeqytetin tonë, Prishtinë. Projekti u karakterizuar më një fushatë mediale të shtjellimit të këtij fenomeni, fuqizimit të rolit të Këshillave të Shkollave si dhe avokimit që Kosova të ketë strategjinë kombëtare për përmirësim të sigurisë në shkolla. FIQ publikoi edhe një raport cili përmbledhi të arriturat e këtij projekti si dhe punët e mëdha që kanë mbetur për tu bërë nga institucionet tona dhe shoqëria jonë në përgjithësi.

Përgjegjshmëria e institucioneve demokratike ndaj shoqërisë civile

Mbështetur nga fondacioni amerikan National Endowment for Democracy (NED), në tetor 2008, FIQ nisi projektin njëvjeçar, i cili realizohet në partneritet me pesë organizata tjera nga mbarë vendi. Projekti synon që të masë përgjegjshmërinë dhe efikasitetin e institucioneve të vendit, duke regjistruar përvojat e qytetarëve dhe duke i ndarë rezultatet me publikun dhe vet institucionet.

Këto informacione do të mblidhen në intervista të rastit, intervista në zyre me qytetarët që drejtohen tek ne lidhur me problemet që kanë patur apo kanë me ndonjë nga institucionet publike, pastaj do të organizohen takime të rregullta me qytetarë për të marrë përvojat e tyre në raport me institucionet, në mënyrë që të bëhet presion tek institucionet komunale/qendrore që ofrojnë shërbime më cilësore dhe më shumë llogari kundrejt qytetarëve të Kosovës.

Në fund të projektit, do të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse, dhe do të publikohet raporti, i cili do t'u shpërndahet qytetarëve, institucioneve të vendit në të gjitha nivelet. Partner të FIQ-it në këtë projekt janë: Syri i Vizionit, Pejë, Qendra për Zhvillimin e Komunitetit të Biznesit, Gjakovë dhe Communication for Social Development, Graçanicë. Të gjeturat kryesore do të publikohen në vitin 2009, atëherë kur përfundon edhe projekti.

II. Qytetaria Aktive

Duke e parë qytetarinë aktive si mekanizëm kryesor për demokratizimin e vazhdueshëm të vendit dhe mënyrë e vetme për të përfshirë një pjesë të madhe të qytetarëve në proceset e vendimmarrje, FIQ vazhdoi të angazhohet në këtë drejtim.

Aksioni Qytetar FOL'08



Zbehja e rolit proaktiv të shoqërisë civile dhe heshtja e përgjithshme karshi problemeve të mëdha të qytetarëve, e shtyn FIQ-in të mbështesë Aksionin Qytetar FOL'08. FOL'08 është nismë e pavarur e shoqërisë civile që funksionon në kuadër të programit për qytetari aktive të organizatës Forumi për Iniciativa Qytetare. FOL'08 i referohet vitit të pavarësisë - vitit që shënon fundin e sakrificës së nismave qytetare kundrejt statusit politik të

vendit. FOL '08, kërkon nga qytetarët, tanimë të një shteti të pavarur që të reagojnë për të mbrojtur vetë shtetin për të cilin u sakrifkuan dhe punuan.

FOL '08 ka nisur së vepruari në shtator të vitit 2008 për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. Shpenzimi i fondeve publike, konfliktit i interesit, neglizhenca dhe

përgjegjësia institucionale si dhe qasje në informacione zyrtare përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL'08. Në përmbushje të këtyre qëllimeve FOL'08, mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare ndaj vendimmarrjes si dhe të kundërtën, injorancën e vendimmarrësve ndaj qytetarëve. FOL'08 nënkupton një thirrje për kritikë dhe opozitë konstruktive kundrejt politikave jo-funksionale, abuzimit me pushtetin dhe fuqinë politike.

III. Dhënia e granteve – mbështetja e iniciativave qytetare

Përmes këtij programi, FIQ kryesisht ka mbështetur grupe të qytetarëve (këshilla të fshatrave), dhe atë kryesisht në komunitete rurale, për të gjetur zgjidhje për problemet e tyre të përditshme. Problemet e mbledhura, të padiskutuara në forume të ngushta, të pa adresuara në vendin e duhur, kanë mbledhur njerëz të profesioneve të ndryshme, kanë mobilizuar ata për të krijuar për të punuar aktivisht në plane veprimi, që kanë rezultuar në suksese dhe në ndërtim të praktikave për veprime të organizuara, me përfshirje institucionale, por edhe me mundësi për përfitime nga organizata të tjera. Gjatë këtij viti FIQ mbështeti projektet në vazhdim:

Mbështetja për fshatin Raushiq, Pejë



Njerëzit janë ndjerë të lodhur duke u ankuar ndër vite dhe duke mos harruar viktimat e shumta nga rreziqet e rrugës magjistrale që ndan fshatin.

Drejtues të Departamentit të Infrastrukturës Rrugore të Ministrisë së Transporteve kanë marrë pjesë në punën e FIQ-it dhe Këshillit të fshatit Raushiq dhe partnerit tonë në Pejë, OJQ Syri i Vizionit, duke e futur këtë zonë në prioritet të ndërtimit të infrastrukturës rrugore të sigurisë. Ndërsa, që kjo shpresohet të ndodhë,

komuniteti ka vendosur të prej drunjtë e vjetërsuar në oborrin e shkollës, të cilët thyheshin dhe binin duke rrezikuar nxënësit. Ata poashtu, brenda shkollës, kanë hapur kabinetin e ligjëratave të sigurisë, ku policia do të mbajë ligjëratat të rregullta mujore për nxënësit për të shtuar kujdesin dhe vëmendjen e tyre për vetësiguri. Në të njëjtën shkollë, është bërë e mundur ndërrimi i njëzet deryve të vjetra me ato të reja duke bërë kështu një përmirësim të madh në këtë shkollë. FIQ dhe SiV kanë patur kënaqësinë të ndihmojnë këtë komunitet dhe u bëjnë thirrje edhe të tjerëve të bëjnë të njëjtën gjë.

Fshati Lubinje e Epërme, Prizren



Komuniteti i pakicës boshnjake, megjithë ndjenjën e organizimit, nuk ka mund të shtyj autoritetet që të punojnë për problemet e tyre. FIQ i ka mbështetur ata në ndërtimin e raporteve me Policinë, afërsinë me KFOR-in dhe i ka mbështetur në riparimin e rrjetit elektrik, duke hequr shtyllat gati të parrëzuara që rrezikonin çdo ditë banorët dhe shtëpitë e tyre dhe duke vendosur rrjetin e ri elektrik për këtë komunitet. Vlen të theksohet, se ky komunitet duhet të shërbej si model i organizimit. FIQ dhe partneri ynë në Prizren, OJQ Këshilli për Paqe dhe të Drejtat të Njeriut (PHRC) kanë patur kënaqësinë të ndihmojnë këtë komunitet dhe bëjnë thirrje edhe të tjerëve të bëjnë të njëjtën gjë

Aktivitete tjera

Reagimet

Duke parë reagimin ndaj çështjeve me rëndësi si një proces drejt demokratizimit dhe zhvillimit të shoqërisë civile, FIQ ka praktikuar, reagimin publik për zhvillime të rëndësishme në sektorin ku punojmë.

Plani 6 pikësh i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, ka marrë vëmendjen dhe energjinë tonë, sikur të shumë organizatave të shoqërisë civile të vendit, të cilat demonstuan në protesta të mëdha kundër ndarjes juridike të vendit. Në këtë zhvillim, FIQ bashkë me një grup organizatash tjera kishte kërkuar nga kuvendi i Kosovës që të ushtrij mbikëqyrjen e zbatimit të mandatit të EULEX-it në Kosovë.

Vizitat me rëndësi



E bërë sikur një traditë, FIQ edhe këtë vit priti dhe shoqëroi donatorë dhe miq tjerë nga jashtë në takime me akterë të vlefshëm të shoqërisë.

Këtë vit, në zyret tona qëndroi Presidentin e fondacionit Rockefeller Brothers Fund, z.Steven Heinz. Ai ka takuar anëtarët e Rrjetit të organizatave partnere që kishin punuar bashkë me ne në shumë nisma, veçanërisht në mbikëqyrjen civile të sektorit të sigurisë, projekt ky i mbështetur nga RBF.

Në një vizitë vlerësuese të punës trevjeçare

të programit "Vend i Sigurtë" qëndruan edhe z.Michael Hasenau, zyrtar i lartë në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, e cila financoi këtë program për tri vjet me radhë, dhe z.Henry Smith, drejtor i organizatës sonë partnere Saferworld nga Londra.

Gjatë këtij viti, FIQ pati kënaqësinë të takohet dhe diskutojë edhe me deputetin britanik, atë liberal demokrat z.Michael Moore. Ai në këtë vizitë kishte takuar zyrtarë të lartë vendi dhe përfaqësues të shoqërisë civile duke marrë përshtypjet e vendasve për mbështetjen që Qeveria e Britanisë së Madhe ka dhënë këto vite në Kosovë.

Fuqia e artit - shfaqja teatrale "E vërteta në Përkthim"

Duke promovuar dhe jetësuar me sukses bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, FIQ u mobilizua bashkë me organizatat partnere për të sjellë në Kosovë një trupë të madhe teatrale nga Afrika e Jugut, të cilët më rrëfimin e tyre artistik kishin prekur zemrat e miliona njerëzve në mbarë botën.

Shfaqja **"E vërteta në përkthim"** u realizua për tri net edhe para publikut kosovar në Teatrin Kombëtar në kryeqytet, si dhe udhëtoi në veri të vendit. Shfaqja, erdhi në Prishtinë drejtë për së drejti nga Festivali i Edinburgh, në Irlandën veriore, e më parë ishte shfaqur në Ruandë dhe Zimbabve, kurse tani gjendej në turne në Ballkanin Perendimor. Ky turne për Kosovë ishte mbështetur nga fondacionit Rockfeller Brothers Fund me ndihmesë nga Ministria për Kulturë Rini dhe Sport..

Kjo shfaqje e shpërblyer shumë herë, e përcjellur me muzikë nga kompozitori legjendar i gjez-it dhe muzikës botërore Hugh Masekela nga Afrika e Jugut, trajton historinë e një populli në dalje nga konflikti dhe aparthejdi i cili pyet veten "A mund të ballafaqohemi me të kaluarën, për të shpëtuar të ardhmen."

Partnerët e FIQ gjatë vitit 2008

1. Saferworld
2. Syri i Vizionit (SiV), Pejë
3. Community Building Mitrovica (CBM), Mitrovicë
4. Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC) , Gjilan
5. Rrjeti Rinor i Gjilanit (RRRGJ)
6. Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CCSD), Mitrovicë
7. Communication for Social Development (CSD), Graçanicë
8. Qendra për Zhvillimin e Biznesit të Komunitetit (CBDC), Gjakovë
9. Këshilli për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut (PHRC), Prizren
10. Rrjeti Ballkanik i Raportimit Hulumtues (BIRN), Prishtinë
11. Iniciativa për Progres, (INPO) Ferizaj
12. OJQ, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve, Obiliq
13. Drejtoria e Arsimit në Ferizaj
14. Drejtoria e Arsimit në Gjilan
15. Këshilli i Nxënësve të Ferizajt (NKF)
16. Këshilli i Nxënësve të Gjilanit (KNGJ)
17. Këshilli i fshatit Gërmovë, Viti
18. Këshilli i fshatit Palaj, Kastriot
19. Këshilli i fshatit Lubinje e Epërme, Prizren
20. Këshilli i fshatit Raushiq, Pejë

Donatorët e FIQ gjatë vitit 2008

Saferworld

Rockefeller Brothers Fund (RBF)

National Endowment for Democracy (NED)

Balkan Trust for Democracy (BTD)

Pasqyra financiare e Auditimit

Totali i të hyrave: 287,458 euro

Totali i shpenzimeve: 236,418 euro

Stafi

Ferdinand Nikolla
Drejtor ekzekutiv

Nazim Haliti
Menagjer i projektit

Ardiana Basha
Zyrtare e administratës
Sefë Govori
Menaxher i financave

Ramadan Ilazi
Kordinator i aksionit qytetar FOL '08

Petrit Zogaj
Zyrtar i projekteve, FOL '08

Mexhide Demolli
Zyrtare për komunikim me media dhe publik, FOL '08

Bardha Gashi
Zyrtare për monitorimin, FOL '08

Anëtarë tjerë të stafit që kanë punuar gjatë vitit 2008:
David Labrador, Albina Balidemaj, Labinot Salihu, Adelina Sylaj